



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA E FINANCËS DHE E BUXHETIT

Nr 4617/prot.

Gramsh, më 21 /11/2023

RELACION

**“Për dhënien e ndihmës financiare Z.Altin Miraka”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar në ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar ligjit Nr.84/2022 datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” i ndryshuar ligjit 139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore “ si dhe kërkesës me Nr.4617 prot. datë 20.11.2023 të paraqitur nga **Zj.Zamira Miraka**, e cila kërkon ndihmë financiare pasi bashkëshorti i saj Z. Altin Miraka është egzaminuar me një sëmundje të rëndë “mase tumorale Formacion egzofit” e vërtetuar kjo nga Analiza e Biopsisë lëshuar nga “Laboratori Diagnostik Morfololigj” dhe nga Kartela e Daljes së “Qëndës Spitalore UIniversitare Nënë Tereza” ku është trajtuar për sëmundjen e tij.

Shtetësja në fjalë shprehet me anë të kërkesës së saj se prej 4 (katër) muajsh e ushqen bashkëshortin vetëm nëpërmjet sondave të instaluara në ezofag dhe nga mjekët i është rekomanduar që të kryej terapi intensive me kimio terapi dhe më pas kryerjen e një ndërhyrje kirurgjikale dhe e ka të pamundur përballimin nga ana financiare të kurimit pasi të katërt anëtarët e famijes janë të papunë dhe trajtohen vetëm me një ndihmë ekonomike nga Bashkia Gramsh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 4617/2 prot.

Gramsh, më 21 /11/2023

P/VENDIM

Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_ . \_\_\_ .2025

**PËR**  
**DHËNIE SHPËRBLIMI NGA FONDI REZERVË PËR PËRBALLIMIN E**  
**SHPENZIMEVE PËR KURIM**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës datë \_\_.11.2023 pasi mori në shqyrtim , kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga **Zj.Zamira Miraka**, për miratimin e përdorimit të pjesëshëm nga fondi rezervë të planit të buxhetit 2023, mbështetur në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, në ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjit nr.84/2022 datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” i ndryshuar si dhe ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore “ neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 gërma “b”, neni 54 gërma “dh”

**VENDOSI :**

1. Dhënien e masës së shpërblimit në masën 100.000 lekë (njëqind mijë lekë) nga fondi rezervë për **Zj.Zamira Miraka** për të përballuar kurimin të bashkëshortit të saj.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETARI KËSHILLIT

KRYETARI I KËSHILLIT

XHULIA GJINI

ENIS ZANI

Bashkia Gramsh me kërkesën e bërë nga Zj. Zamira Miraka, ku shprehet se bashkëshorti i saj paraqitet me sëmundje të rëndë ndoshta edhe të pashërueshme e cila nuk ka mundësi për përballimin e shpenzimeve për kurimin e vazhdueshëm edhe kimioterapi dhe ndërhyrje kirurgjikale, mendon ti vijë në ndihmë e ti ofroj një ndihmë financiare prej 100.000 lekë për ti lehtësuar sado pak pamundësinë e saj financiare dhe vështirësitë në të cilat gjenden.

Bashkangjitur gjeni dokumentacionin provues për rastin ne fjalë.

1. Kërkesa
2. Karta e identitetit
3. Përmbledhje e Daljes nga Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza”
4. Analiza e Biopsisë lëshuar nga “Laboratori Diagnostik Morfolologj”



**KRYETARI**  
**Besion AJAZI**